



UDHËZUES PËR MEDIA

RAPORTIMI I RASTEVE
TË TRAFIKIMIT ME NJERËZ

Shtypi i kësaj broshure është mbështetur nga
Misioni i OSBE-së në Kosovë.



UDHËZUES PËR MEDIA

Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës (MPB), Policia e Kosovës (PK) dhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), pranojnë rolin e mediave në ngritjen e vetëdijes dhe parandalimin e trafikimit me njerëz. Si rezultat, në bashkëpunim të ngushtë ata kanë hartuar udhëzimet për gazetarët që raportojnë për rastet e trafikimit me njerëz, me qëllim që t'ua sigurojnë atyre këtë instrument të vlefshëm që do tu ndihmojë në mbulimin e këtij krimi kundër të drejtave të njeriut përmes qasjes “viktimat së pari”.

Raportimi profesional dhe i informuar për trafikimin me njerëz është shumë i nevojshëm, jo vetëm për ta informuar publikun për krimin por, mbi të gjitha, për të parandaluar personat e ceneshëm që të mos bëhen viktima të trafikimit.

Fundi i Trafikimit me Njerëz do të jetë i mundur vetëm me përpjekje të bashkuara dhe të harmonizuara të institucioneve të Kosovës, sektorit privat, shoqërisë civile dhe mediave.

ROLI I MEDIAS

VETËDIJESIMI - Ndonëse trafikimi me njerëz ndodh rreth nesh, shumica e njerëzve nuk kanë njoħuri pér tē. Mediat mund tē ndihmojë nē ngritjen e vetëdijesimit mbi trafikimin e qenieve njerëzore.

PARANDALIMI - Informata mund t'i fuqizojë njerëzit e rrezikuar dhe t'i paralajmërojë ata rreth rreziqeve dhe kërcënimeve. Mediat mund tē ndihmojnë nē fuqizimin e popullatës nē nevojë.

NJOHURI - Shoqëria ka pak njoħuri pér trafikimin me njerëz. Mediat mund tē japid më shumë informata mbi partitë dhe rrjetet e përfshira. Mediat mund tē ndihmojnë nē rritjen e njoħurive tē komuniteteve mbi trafikimin me njerëz pér tē gjetur zgħidhje më tē mira.

Prandaj, Udhëzuesi pér Media nē lidhje me Trafikimin me Njerëz paraqet një instrument tē vlefshém pér gazetarét, kur tē shkruajnë pér viktimat e trafikimit, si dhe kur tē mbulojnë natyrën komplekse tē trafikimit me njerëz, nē ményré tē drejtë, tē balancuar dhe etike.

ÇFARË ËSHTË TRAFIKIMI ME NJERËZ?

Trafikimi me njerëz është proces përmes të cilit individët vendosen ose mbahen në situatë shfrytëzuese për përfitime ekonomike. Trafikimi mund të ndodhë brenda një shteti ose mund të përfshijë lëvizje përtej kufijve. Gratë, burrat dhe fëmijët trafikohen për një sërë qëllimesh, përfshirë për punë të detyruar dhe ekspluatuese në fabrika, ferma dhe shtëpi private, kërkim lëmoshe, shfrytëzim seksual dhe martesë të detyruar. Trafikimi prek të gjitha rajonet dhe shumicën e vendeve të botës.

ELEMENTET KYÇE TË TRAFIKIMIT ME NJERËZ

Tri elementet kryesore që duhet të jenë të pranishme për të ekzistuar një situatë e trafikimit me njerëz (të rritur) janë:

Akti (çfarë është bërë) - Rekrutimi, transporti, transferimi, strehimi ose pranimi i personave.

Mjeti (si është bërë) - Kërcënimi ose përdorimi i forcës, shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthitjes, abuzimit të pushtetit ose cenueshmërisë, ose dhënia e pagesave ose përfitimeve për një person i cili e ka viktimin nën kontroll.

Qëllimi (pse është bërë) - Me qëllim të eksplotimit, që i cili përfshin shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve, shfrytëzimin seksual, punën e detyruar, skllavërinë ose praktikat e ngjashme dhe heqjen e organeve dhe qelizave.

METODAT MË TË SHPESHTA TË REKRUTIMIT TE TRAFIKIMI ME NJERËZ

Metodat më të shpeshta që përdoren për trafikimin e njerëzve përfshijnë format e mashtrimit si joshja dhe romanca, premtimet e rreme/mashtruese për martesë ose bashkëjetesë, premtimet për të studiuar ose punuar jashtë vendit (kamerierë, valltarë, banakierë, premtimet për pagë të mirë mujore dhe punë të ligjshme), oferta për modelim/ modë/ gara bukurie, kontakti përmes rrjeteve sociale (Facebook, Twitter,) etj.

Kush mund t'i referojë viktimat e trafikimit?

Sipas Ligjit për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimateve, dhe Procedurave standarde të operimit për personat e trafikuar në Kosovë, referimi mund të bëhet nga:

- Institucionet e ndryshme qeveritare dhe agjencitë zbatimit të ligjit
- OJQ të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare
- Mediat
- Qytetarët në përgjithësi.

Ndërsa institucionet e mëposhtme identifikojnë viktimat e trafikimit

- Policia e Kosovës/hetuesit policorë nga Drejtoria për Hetime të Trafikimit me Qenieve Njerëzore
- Prokurori
- Mbrojtësi i viktimateve (Prokuroria e Shtetit)
- Punëtorët socialë nga Qendra për Mirëqenie Sociale

DISA PREJ TË DREJTAVE TË VIKTIMAVE:

- E drejta në mbrojtje dhe banim
- E drejta në konfidentialitet
- E drejta për t'u trajtuar me respekt dhe dinjitet
- E drejta në kompensim / reparacion
- E drejta në qasje në procedurë gjyqësore
- E drejta në gjykrim
- Mos e gjykonit viktimën se ajo/ai është fajtor(e) për atë që i ka ndodhur.
- Mbrojtja e konfidentialitetit të viktimës / kujdesi në paraqitjen e imazheve që dëmtojnë integritetin e tij/saj, etj.

Treguesit e hershëm për identifikimin e viktimate të trafikimit me njerëz

Gjatë punës në terren, gazetarët shpeshherë takojnë persona që mund të jenë viktima të trafikimit. Prandaj është e rëndësishme të identifikohen disa nga treguesit e hershëm që mund të kontribuojnë në identifikimin e viktimate të moshave dhe gjinive të ndryshme.

- Nëse deklaron se është abuzuar, kërcënuar, ekspluatuar dhe tregon shenja të qarta se po kërkon ndihmë;
- Ka shenja në trup që tregojnë abuzim fizik ose seksual ndaj tij/saj;
- Gjithmonë është një person i moshës madhor që i rri pranë për ta kontrolluar;
- Nuk ka kontakt me familjen apo person të lidhur me gjak që të kujdeset për të;
- I/e paregjistruar në vendin / qytetin ku është sjellë nga një person i rritur me të cilin nuk ka lidhje familjare;

- Personi ka hyrë në një situatë eksplotimi përmes rrëmbimit ose përmes premtimit që është dëshmuar të jetë i rremë.
- Personi është i detyruar të mbetet në situatë eksplotimi për shkak të kërcënimeve dhe dhunës ndaj tij /saj ose të afërmve të tij/saj.
- Personi nuk ka kontroll mbi jetën e tij/saj: lëvizja, strehimi, përdorimi i të ardhurave, kontrolli mbi dokumentet jetësore (p.sh. pasaportat), drejtohen dhe kontrollohen nga persona të tjera.
- Transporti, banimi, punësimi i personit rregullohen nga persona të njojur, ose që njihen të jenë trafikantë ose përdorues.

GAMA E KRIMEVE TË LIDHURA ME TRAFIKIMIN

Rastet e trafikimit me njerëz mund të shoqërohen edhe me vepra të tjera penale. Ato gjithashtu mund të shërbejnë si tregues të hershëm!



GJATË RAPORTIMIT KENI KUJDES PËR DALLIMET MIDIS TRAFIKIMIT ME NJERËZ DHE KONTRABANDËS SË IMIGRANTËVE

Për gazetarët, dhe në disa raste për autoritetet, është shumë i vështirë dallimi midis kontrabandës dhe trafikimit, meqë ndonjëherë ato janë të mbivendosura. Për më tepër, përcaktimi i faktit nëse një gazetar duhet të mbulojë një rast të trafikimit njerëz ose kontrabandës së imigrantëve dhe kimeve të lidhura me të mund të jetë shumë i vështirë.

Disa persona të trafikuar mund ta fillojnë udhëtimin e tyre duke u dakorduar për tu kontrabanduar në një shtet në mënyrë të paligjshme, por më vonë në këtë proces e gjejnë veten të mashtruar, shtrënguar ose detyruar në një situatë ekspluatimi.

Kontrabandimi i imigrantëve - nënkupton çdo veprim me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë financiar ose tjetër material përmes futjes së paligjshme të një personi në Kosovë i cili mund të jetë apo jo shtetas i Kosovës.

Kalimi i kufijve shtetërorë - elementi thelbësor për kontrabandën me një imigrant është kalimi kufitar. Ndërsa trafikimi me njerëz është krim edhe i brendshëm edhe global, me viktima të trafikuara brenda shtetit të tyre, në shtetet fqinje por edhe më gjerë.

Eksplotimi i viktimave - nuk ekziston në punën e kontrabandës me imigrantë edhe pse kontrabanduesit paguajnë për udhëtimin deri në destinacion.

Për të sqaruar nëse një rast është kontrabandë me imigrantë, gazetari duhet t'i kërkojë treguesit e mëposhtëm:

Pëlqimi - kontrabandimi i imigrantëve, edhe pse shpeshherë kryhet në kushte të rrezikshme ose degraduese, përfshin dhënien e pëlqimit. Viktimat e trafikimit, nga ana tjeter, ose nuk kanë dhënë pëlqimin e tyre kurrë ose, nëse fillimisht janë pajtuar, ai pëlqim më nuk është i vlefshëm pas veprimit shtrëngues, mashtrues ose abuziv të trafikantëve.

Eksplotimi - kontrabandimi i imigrantëve përfundon me ardhjen e imigrantëve në destinacionin e tyre, ndërsa trafikimi përfshin eksplorimin e vazhdueshëm të viktimës.

Transnacionaliteti ndërkontrollor - kontrabanda është gjithmonë transnationale, ndërsa trafikimi mund të mos jetë. Trafikimi mund të ndodhë pavarësisht nëse viktimat janë dërguar në një shtet tjeter ose transferohen brenda kufijve të një shteti.

Burimi i fitimeve - në rastet e kontrabandës fitimet rrjedhin nga transportimi për lehtësimin e hyrjes ose qëndrimit të paligjshëm të një personi në një shtet tjeter, ndërsa në rastet e trafikimit fitimet rrjedhin nga eksplorimi.

MBANI MEND

Pavarësisht se sa e parëndësishme mund të duket, ky konfuzion mund të bëjë që audiencia t'i keqkuptojë faktet. Gjithashtu, mund ta vështirësojë identifikimin e hershëm të viktimateve duke larguar vëmendjen nga problemi i vërtetë ndërsa shuma e manipulimit mendor e detyron viktimën të ketë më pak besim tek dikush tjetër përveç mbajtësve të tyre të paligjshëm.

TRAFIKIMI I FĒMIJĒVE

Trafikimi i njerëzve, qoftë i fëmijëve apo të rriturve, është shkelje e të drejtave të njeriut. Në rastin e personave që nuk kanë mbushur moshën madhore, kjo gjithashtu shkel të drejtat e tyre si fëmijë, veçanërisht të drejtën e tyre për t'u mbrojtur nga eksplorimi. Kërcënimi ose përdorimi i forcës ose formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit ose lajthimit, ose abuzimit të pushtetit ose pozitës së ceneseshme në çdo pikë të rekrutimit dhe lëvizjes nuk kanë nevojë të janë të pranishme në rastin e fëmijëve (përveç me të rriturit), por megjithatë janë tregues të fortë të trafikimit të fëmijëve. (Nga ILO, UNICEF, UN.GIFT, Manual trajnimi për të luftuar trafikimin e fëmijëve për eksplorim për punë, seksual dhe forma të tjera, 2009)

SI TË INFORMOHENI

Në vend që të mbështeteni në burime dytësore, siç është kumtesa apo njoftimi për shtyp, mediat/gazetarët duhet të përpilen të kryejnë intervista me të gjithë aktorët përkatës sa herë që të jetë e mundur, në mënyrë që t'i marrin të gjitha anët e stories. Intervistat duhet të jenë burimi kryesor, mjeti kryesor për gazetarët që raportojnë mbi rastet e trafikimit me njerëz, meqë i ndihmon ata t'i kapin të gjitha pjesët e tregimit. Intervistat me të gjithë aktorët janë të domosdoshme për ta fituar pasqyrën e plotë, ndonëse kjo nuk është gjithmonë e mundur. Përdorni gjykimin tuaj gazetaresk për të kërkuar sa më shumë.

Shfrytëzoni ekspertët dhe profesionistët e fushës për t'i verifikuar burimet sekondare!

INTERVISTIMI I VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

Ata që janë trafikuar kanë pësuar shkelje të të drejtave të tyre të njeriut. Sigurohuni që i keni marrë të gjitha masat për të mbrojtur identitetin e viktimestës përveç nëse nuk intervistoni persona që janë pajtuar ta zbulojnë identitetin e tyre.



Mos e zbuloni identitetin e fëmijës edhe nëse ju jepet leja nga prindërit ose kujdestarët ligjorë. Mbani ndjeshmëri të shtuar dhe njoftoni dhe tregoni viktimës se nuk ka problem edhe nëse refuzon t'u përgjigjeni pyetjeve me të cilat nuk ndihet rehat.

Mos incizoni /filmoni bisedën pa marrë pëlqimin e të intervistuarit/ viktimës! Informoni viktimën se do t'i publikoni vetëm ato pjesë të stories me të cilat viktima ndihet rehat.

Mos përdorni fotografi dhe video-xhirime të arkivit për të ilustruar një storie. Imazhet që shoqërojnë lajmet e trafikimit me njerëz shpeshherë demonstrojnë mungesë të ndjeshmërisë ndaj viktimave dhe stereotipizojnë ato.

Bëni dallimin midis viktimave të trafikimit me njerëz dhe prostitucionit vullnetar!

Trafikimi seksual mund të përfshijë prostitucion, por jo çdo prostitucion është medoemos trafikim seksual. Janë dy faktorë kryesorë që dallojnë ato. Trafikimi përfshin një përfitues të palës së tretë, do të thotë dikush tjetër duhet të përfshihet.

Eksplotimi i viktimave - përfshin, mes tjerash, prostitucion, pornografinë ose format e tjera të eksplotimit seksual.



Prostitucioni vullnetar - kur dikush angazhohet "me dëshirë" në veprimtari seksuale në këmbim të pagesës.



Identifikoni vlerën e imazheve dhe mendoni se në çmasë mund të paraqitet në media pa fyer ose larguar audiencën. Duke e ekzagjeruar qëllimisht, për qëllime të promovimit të storieve, mediat mund t'i dëmtojnë indirekt viktimat e trafikimit me njerëz.

Raportimi mbi fëmijët që janë viktima të trafikimit me njerëz

Raportimi i storieve të trafikimit me njerëz që përfshijnë fëmijë dhe të rinj paraqet sfidë të veçantë për gazetarët. Në fakt, mbulimi joetik ose jo i duhur i vë fëmijët në rrezik të madh. Keni shumë kujdes kur zgjidhni imazhe për të ilustruar një storie. Sigurohuni që fëmijët të portretizohen me dinjitet. Të miturit dhe fëmijët që përfundojnë në duart e trafikantëve janë veçanërisht të cenueshëm dhe nuk i kuptojnë disa ose të gjitha kushtet në të cilat gjenden, ose nuk kanë qasje në shërbime të ndihmës. Edhe më të rrezikuar janë fëmijët me aftësi të kufizuara fizike, të cilët shpeshherë janë mësuar të kërkojnë lëmoshë. Kur raportojnë për fëmijët viktima të trafikimit, mediat duhet të shmangin kriminalizimin e të miturve, duke pasur parasysh që edhe nëse fëmija është i përfshirë në kundërvajtje, ai/ajo megjithatë viktimë e krimtit.

Shmangni sensacionalizmin dhe stereotipat kur të raportoni për viktimat e trafikimit me njerëz

Trafikimi i njerëzve për nga natyra e tij është krim traumatik, ndonjëherë i dhunshëm. Është e domosdoshme që gazetarët t'i paraqesin faktet e rastit dhe të shmangin spekulimet.

Kur keni të bëni me trafikim të grave, mos përdorni foto të vajzave lakuriq ose gjysmëlakuriq duke kërcyer, meqë ato thjesht bëjnë që lexuesi/shikuesi të barasvlerësojë trafikimin me njerëz me prostitucionin, të cilat janë çështje të ndryshme.

FJALOR QË DUHET TË PËRDORET KUR TË SHKRUANI/RAPORTONI MBI TRAFIKIMIN ME NJERËZ

Autoritet - të gjitha institucionet e Kosovës në përputhje me nenin 6 të ligjit nr. 04/L - 218 ligj për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimate të trafikimit;

- Ministria e Punëve të Brendshme (MPB),
- Policia e Kosovës (PK),
- Ministria e Mirëqenies Punës dhe Sociale (MPMS),
- Ministria e Shëndetësisë (MSH), dhe
- Ministritë e tjera dhe institucionet e tjera, ofruesit e shërbimeve në kuadër të këtyre institacioneve, i cili në bazë të këtij ligji apo ndonjë ligj tjetër përkatës është i autorizuar që të merret me parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe sigurimin e ndihmës dhe mbrojtjes së viktimate të trafikuara.”

Fëmijë - personi i cili është nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç.

Shteti i destinacionit - Shteti që është destinacioni përfundimtar i një personi të trafikuar (referohet edhe si “shteti pritës”).

Shteti i origjinës - Shteti prej nga vjen personi i trafikuar (referohet edhe si “shteti i burimit”).

Shteti i tranzitit - Shteti ku një person i trafikuar udhëton për të arritur në destinacionin e tij përfundimtar.

Eksplotimi i viktimes - përfshin, por nuk kufizohet në, shfrytëzimin e prostitucionit të tjerve, pornografisë ose formave tjera të shfrytëzimit seksual, lëmoshës, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve apo qelizave.

Punë e detyruar - çfarëdo lloj pune apo shërbimi i kërkuar nga një individ nëpërmjet kërcënimit me një ndëshkim, për kryerjen e së cilës individi nuk ka shprehur dëshirën e tij;

Martesë e detyruar – një formë servile apo fiktive e martesës së personave përderisa ato përmbajnë elementet konstitutive të trafikimit me njerëz, në pajtim me Kodin Penal të Kosovës. Kur një fëmijë është në pyetje, nuk do të merret parasysh asnjë pëlqim i fëmijës për ndonjërin nga veprimet e mësipërme;

Personi i identifikuar i trafikuar - personi i cili është identifikuar si viktimë e trafikimit sipas një identifikimi zyrtar ose joformal.

Strehimi - premisat ku personat e trafikuar janë vendosur gjatë fazës së riintegrimit. Strehimoret mund tëjenë të hapura ose me liri të kufizuar të lëvizjes të justifikueshme në lidhje me vlerësimin e rrezikut.

Adoptim i paligjshëm - çdo institucion apo praktik ku një fëmijë dorëzohet nga njeri ose të dy prindërit e tij natyral ose nga kujdestari i tij te një person tjetër, qoftë për shpërblim apo jo, me qëllim të shfrytëzimit të fëmijës apo personit të ri ose të punës së tij.

Grupi Punues Ndërmistror (GPNM) - është i përbërë nga përfaqësues të institacioneve qendrore të mandatuara për të koordinuar, zbatuar, monitoruar dhe raportuar mbi përparimin e arritur në parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz.

Policia e Kosovës , në veçanti Drejtoria e Hetimeve të Trafikimin me Njerëz (DHTQNJ) -

është përgjegjëse për parandalimin e krimit, hetimet penale, arrestimin e autorëve, mbrojtjen e personave të trafikuar, kryerjen e masave siç parashikohet nga PSV për personat e trafikuar në Kosovë, nxjerrjen e raporteve të rregullta me të dhëna mbi rastet dhe trendet e trafikimit.

Autoriteti Kombëtar - Autoriteti Kombëtar përbëhet nga autoritetet e përcaktuara në paragrafin AUTORITETET dhe institucionet e tjera relevante nga fushëveprimet e ndryshme shtetërore, përfshirë edhe përfaqësuesit e ofruesve të shërbimeve vendore qeveritare dhe joqeveritare.

Mekanizmi kombëtar i referimit - i referohet mekanizmit kombëtar të referimit të viktimateve, i cili është krijuar për të identifikuar, kthyer dhe ndihmuar viktimat e trafikimit. Këta mekanizma ekzistojnë në vendet e tranzitit, destinacionit dhe origjinës dhe referojnë raste (të drejtpërdrejta) në të gjithë sistemin/procesin e referimit në nivelin kombëtar, nga identifikimi fillestar deri në ndihmën dhe mbrojtjen, duke promovuar bashkëpunimin midis institucioneve të ndryshme qeveritare dhe aktorëve joqeveritarë.

Koordinatori Kombëtar Kundër Trafikimit (KKKT) - emërohet nga Qeveria dhe është i mandatuar të koordinojë, monitorojë dhe raportojë për zbatimin e politikave kundër trafikimit me njerëz, si dhe të kryesojë Grupin Punues Ndërministror (GPNM).

Viktima e supozuar e trafikimit - person që supozohet të jetë viktimë e trafikimit me njerëz, por që nuk është identifikuar formalisht nga autoritetet relevante, ose që ka refuzuar të identifikohet formalisht dhe zyrtarisht si e tillë. Personat e supozuar si të trafikuar gjëzojnë të njëjtat të drejta dhe trajtim si edhe viktimat e identifikuara që nga fillimi i procesit identifikues.

Personi i mundshëm i trafikuar - çdo person (i mitur ose i rritur) që nuk është trafikuar, por duke pasur parasysh profilin e tij/saj ose shfaqjen e treguesve të caktuar, mund të jetë i ceneshëm nga trafikimi me njerëz.

Mbrojtja - I referohet procedurave për të siguruar sigurinë fizike të personit të trafikuar dhe ruajtjen e perspektivës së tij/saj të përfshirjes sociale në vendin e origjinës, destinacionit ose një vendi të tretë.

Rikuperimi - Procesi përmes së cilit personat e trafikuar stabilizohen dhe mirëqenia e tyre rikthehet nga aspekti psikologjik, social dhe fizik.

Riintegrimi - Riintegrimi ose integrimi është i përqendruar në fuqizimin e personit të trafikuar, ribashkimin e tij/saj me familjen ose komunitetin, ose integrimin e tij/saj në një komunitet të ri.

Shërbimet sociale - Shërbimi i ofruar viktimateve dhe grupeve të cenueshme, për të përmbushur nevojat e tyre të menjëherëshme ose afatgjata.

Fëmija i trafikuar - Çdo person nën moshën tetëmbëdhjetë vjeçë, i cili rekrutohet, transportohet, transferohet, strehohet ose pranohet me qëllim të eksplloatimit, brenda ose jashtë vendit, edhe nëse nuk përdoret ndonjë element të detyrimit, mashtimit, abuzimit të pushtetit ose ndonjë formë tjetër abuzimi.

Personi i trafikuar - personi i cili është subjekt i krimtit të trafikimit me njerëz.

Trafikuesi - Personi i përfshirë në trafikimin e një njeriu tjetër (ose njerëzve) për çdo forme të ekspluatimit.

Komisioni - komision për pranimin, shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesave për kompensim, të viktimate të trafikimit me njerëz.

Viktima e trafikimit - personi i vendosur ose mbajtur në një situatë ekspluatimit për përfitime ekonomike.

Mbrojtësi i Viktimateve - personi i caktuar nga Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmën Viktimateve.

Victimë e ndjeshme - fëmijë, person me aftësi të kufizuara fizike apo mendore, person me aftësi të zgjogëluar, grua shtatzënë ose partner familjar, siç përcaktohet me Kodin Penal të Kosovës.

Raportimi dhe referimi i viktimate të trafikimit!

Mbulimi i suksesshëm në media i trafikimit me njerëz mund të nxjerrë në pah përpjekjet e bëra kundër trafikimit me njerëz, partneritetet ekzistuese që punojnë për të ndaluar krimin dhe historitë e suksesit të të mbijetuarve, punonjësve socialë, zbatuesve të ligjit dhe shumë njerëzve të tjerë që bëjnë punë të jashtëzakonshme. Storiet që mund t'i frymëzojnë të tjerët që të përqendrohen në zgjidhje dhe jo në probleme janë mënyrë e fuqishme e komunikimit me publikun.

Nëse vëreni ndonjërin prej treguesve të mësipërm, bashkëpunoni me agjencitë e zbatimit të ligjit për të shpëtuar jetë, ndajeni informacionin sa më parë me policinë me qëllim të identifikimit të hershëm dhe shpëtimit të viktimës.

RAPORTONI TRAFIKIMIN ME NJERËZ

**LINJA TELEFONIKE E NDIHMËS
0800 11 112**

**POLICIA E KOSOVËS
192**

**EMAIL
antitrafikimi@kosovopolice.com**